



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 4709 prot.

Tiranë, më 31/8 /2026

URDHËR

Nr. 240, datë 31/8 /2026

PËR

**PËRLLOGARITJEN DHE PËRFITIMIN E PAGËS REFERUESE BAZË TË
GJYQARËVE TË GJYKATËS SË LARTË DHE KËSHILLTARËVE LIGJORË TË
NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR**

Në zbatim të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 7, 26 dhe 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 95, 96 dhe 97 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; të neneve 2, 3, 4, 19, 20, 21, 43, 44, 45, 50, 51 dhe 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”; të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.02.2026; të udhëzimit nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026” të ministrit të Financave; si dhe të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Mbi miratimin e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), sipas vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese”;

- në mbështetje të parimit sipas të cilit pavarësia e pushtetit gjyqësor, e sanksionuar nga nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës, nuk kufizohet vetëm në pavarësinë vendimmarrëse të gjyqtarit, por kërkon edhe garanci institucionale e financiare që e mbrojnë ushtrimin e funksionit gjyqësor nga ndërhyrjet, presionet ose ndikimet e jashtme;

- duke vlerësuar se paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera të gjyqtarit, e garantuar posaçërisht nga neni 138 i Kushtetutës, përbën një garanci kushtetuese të pavarësisë së gjyqtarit

dhe të vetë pushtetit gjyqësor, ndaj trajtimi financiar duhet t'i përgjigjet dinjitetit, përgjegjësisë dhe rëndësisë së funksionit gjyqësor;

- nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila, në vijim të standardeve të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026, ka ritheksuar se mbrojtja kushtetuese e pagës nuk shtrihet vetëm ndaj uljes së drejtpërdrejtë në vlerë nominale, por edhe ndaj uljeve të fshehura ose faktike, përfshirë ngrirjen e shënjestruar të pagës në raport me zhvillimet ekonomike, rritjen e çmimeve dhe rritjet domethënëse të pagave referenciale në sektorin publik;

- në konkretizim të këtij standardi, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026, ka përcaktuar se rregullimi i pagës së magistratëve duhet të mbështetet në kritere objektive, të parashikueshme, të qëndrueshme dhe transparente, të shmangë elementet arbitrare ose diskrecionale dhe të ruajë përshtatshmërinë e pagës me funksionin dhe vlerën e saj reale;

- duke mbajtur parasysh se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026, ka detyruar Kuvendin të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme brenda datës 31.07.2026 dhe ka përcaktuar që efektet e shfuqizimit të dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 33/2023 të hyjnë në fuqi, në çdo rast, jo më vonë se kjo datë;

- përderisa, në kuptim të nenit 132 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme, zbatimi i tyre duhet të realizohet në përputhje me standardet kushtetuese të arsytimit që lidhen drejtpërdrejt me dispozitivin;

- duke iu referuar vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si akti që konkretizon për sistemin gjyqësor pagën referuese bazë të magistratit në zbatim të vendimit nr. 15, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij;

U R D H Ë R O J:

1. Duke filluar nga data 1 gusht 2026, paga referuese bazë e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë përlllogaritet në përputhje me standardet kushtetuese të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 35, datë 22 nëntor 2022, të interpretuara dhe konkretizuara më tej në vendimin nr. 15, datë 17 shkurt 2026, si dhe sipas përcaktimeve të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Paga referuese bazë e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri të përlllogaritet duke marrë si referencë pagën që përfitojnë nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, Kategoria I, Klasa I-2, sipas vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave (të ndryshuar).
3. Paga referuese bazë, sipas pikës 1 të këtij urdhri, përbëhet nga:
 - a) paga për pozicion (në shumën 222.425 lekë, sipas klasës;

- b) shtesa e nivelit të kualifikimit “Grupi i diplomës 1” (në shumën 14.000 lekë), për periudhën nga data 01 gusht 2026 e në vazhdim. Paga referuese bazë rezulton në total në shumën 236.425 lekë.
4. Përlllogaritja e efekteve financiare për periudhën përpara datës 1 gusht 2026 dhe përfitimi i diferencave përkatëse të pagës bëhen sipas përcaktimeve të vendimit nr. 435, datë 26.08.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
 5. Parashikimet e këtij urdhri zbatohen *mutatis mutandis* edhe për përlllogaritjen e pagës referuese bazë të këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor.
 6. Ngarkohet struktura përgjegjëse për financën në Gjykatën e Lartë për zbatimin e këtij urdhri, për përlllogaritjen e pagës referuese bazë sipas përcaktimeve të mësipërme dhe për kryerjen e veprimeve financiare përkatëse, në përputhje me legjislacionin buxhetor dhe financiar në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 01.08.2026.

KRYETARI
SOKOL SADUSHI

